Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0011

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE Petrol Company - SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me disel dhe benzin" me numër të prokurimit 12997 12998-23-13076-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Trepça SH.A., më 15/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Petrol Company - SH.P.K."- me nr. 2024/0011 , e datës 05.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me disel dhe benzin" me nr. të prokurimit: "12997 12998-23-13076-1-1-1"inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Trepça SH.A.

2.Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -Trepça SH.A. lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.11.2023 Trepça SH.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me disel dhe benzin" me nr. të prokurimit: "12997 12998-23-13076-1-1-1". Ndërsa me datë 21.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate "Delta Group- Sh.P.K."

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës : 158,000.00 €.

Me 26.12.2023, OE "Petrol Company - SH.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 28.12.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Petrol Company - SH.P.K." me nr. 0011/2024 lidhur me aktivitetin "Furnizim me disel dhe benzin" me nr. të prokurimit: "12997 12998-23-13076-1-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Petrol Company - SH.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë: "Konsiderojmë se Trepça SH.A ka shkelur nenin 7 (diskriminimin) te LPP sepse ka diskriminuar Kompaninë tone duke propozuar me shpërblim për Kontrate OE i cili NUK plotëson kushtet e përcaktuara ne Dosje te tenderit sepse ne FDT neni 9.1 dhe 9.2 për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar nga OE qe te dorëzohet licenca e shitjes me pakicë për pikat e karburantit ku OE ofron furnizime me karburant te cilat i ka ne pronësi apo me qera VALIDE. Ne kërkesën për sqarim OE ju ka informuar se pika shitëse për rajonin e Prishtinës është ne Gadime te Poshtme-Llugagji dhe për ketë pike OE nuk ka prezantuar licencë ne momentin e dorëzimit te ofertës dhe për këtë arsye jemi diskriminuar nga ana juaj sepse ofertat e dorëzuara nga ana e OE nuk është vlerësuar ne përputhje me kërkesat e përcaktuara ne Dosje te tenderit dhe ne përputhje me dispozitat e LPP dhe Rregullores se Prokurimi . Ne vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim AK e ka cekur qe furnizimet për automjete i bëjnë ne pompat e tyre ne Stanterg dhe Kishnic ku ky arsyetim nuk është i vërtet sepse ne kemi kontratë disa vjeçare me Trepça Sh. A dhe te gjitha automjetet me diese janë furnizuar ne pikat e OE dhe ne Vendimin për kërkese për rishqyrtim Trepça e ka cekur qe pikat e furnizimit me pakicë përdoren për Benzin por Pika e OE te shpërblyer me kontratë për rajonin e Prishtinës nuk është e licencuar dhe nuk është pranuar asnjë licencë nga AK për këtë pike prandaj mendojmë se AK ka bere shkelje sepse do te furnizohet me derivate ne një pike e cila nuk është e licencuar nga Ministria e Tregtisë. Trepça SH.A me ketë rast ka shkelur edhe parimin e transparencës dhe nenin 27 te LPP (Dosja e tenderit), Gjithashtu duhet te ceket se pika e furnizimit për Regjionin e Prishtinës është 24 km larg Prishtinës ne një drejtim dhe ne te dy drejtimet 48 km dhe ne piken për rajonin e Mitrovicës është caktuar pompa ne Ternac-Skenderaj e cila është ne distancë ne njërin drejtim 15km dhe ne te dy drejtimet 30 km dhe nëse llogariten kostot e shpenzimeve për automjetet me shume do te shpenzojnë automjetet ne vajtje-ardhje për furnizim se sa për përdorimin tyre për punët e përditshme".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7, 27, 59, 60 të LPP-së.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: "l. Pretendimet e OE se AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabarte OE në përputhje me nenin 7 të LPP-së nuk qëndron, sepse tenderuesit janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë te detajuar dhe të barabartë, dhe komisioni i vlerësimit c ka propozuar për shpërblim tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. 2.OE i cili është shpërblyer me kontratë i ka plotësuar te gjitha kriteret për kualifikimin si tenderues i përgjegjshëm nga aspekti administrative ,aspekti i pranueshmërisë, nga aspekti profesional ,aspekti teknik dhe financiar, kur është qështja te kapacitetet teknike dhe profesionale: OE ka ofruar: licencat e shitjes me shumicë valide licenca e transportit valide, Licenca valide për pikat ku OE Operon me pakicë. Ne si OE-në dosjen e tenderit në aneksin nr.1 nuk kemi kërkuar distancë të operimit nga seli tona Operuese, andaj kjo që ju pretendoni nuk qëndron, dhe ne ju

përkujtojmë Neni 51-LPP-Njoftimi i kritereve të Përzgjedhjes l. Autoriteti kontraktues duhet të theksoje në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret c përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose procedurave konkurruese nis negociata , për të pranuar një ftesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatoret ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet c kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. 2.Autoriteti kontaktues duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin c kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen c tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë. Të gjitha këto kërkesa për dokumente dhe informata do të kufizohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori përkatës ekonomik: (i) nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas Prandaj ne nuk kemi të drejtë të kërkojmë tjera kritere gjatë vlerësimit pos plotësimit të atyre kritereve qe janë paraqitur në dosje të tenderit. Duhet t'ju përkujtojmë se ne kemi rezervuar për deponimin e karburanteve në Minierën e Stantërgut dhe në Flotacionin në Kishnicë, pasi ku mund të furnizohemi edhe për automjete dhe automobile. Ne nuk e keni përcaktuar në specifikim teknik ne aneksin nr.l të dosjes së tenderit apo te kapacitetet teknik distancën e pikave të shpërndarjes me pakicë .Komisioni i vlcrësimit ka kërkuar një sqarim me shkrim në mënyrë shoqërore se ne si „AK„ të na informoj se ku mundemi me u furnizuar me derivate për automjete, dhe OE: Delta group "Sh.P.K na ka ofruar dy pika që ne mund të furnizohemi. Këto pika furnizimi me pakicë më tepër na shërbejnë për furnizim me Benzinë ,sepse furnizimet me naftë mund ti bëjmë përmes pompave në Njësit tona në Stantërg dhe Kishnicë, Ju Njoftojmë se Trepça Sh.A Nuk e ka bërë shpalljen përmes AQP-së. Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit ka vepruar në bazë të ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në paragrafin nr:6,7,10,dhe rregulloren dhe udhëzuesin e prokurimit Publik. Kemi bërë vlerësimin një përputhje një neni 59 pika 4 si nenin 69. Dhe vendimi i „AK, Trepça ka qene për OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët OE: Delta Group Sh.P.K."

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 11/2024, ndërsa me datë 06.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/11 me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, po ashtu edhe OE Nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/11 të pretendimeve ankimore të OE "Petrol Company - SH.P.K ankues, si në vijim;

Konstatimi i parë (I): "Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik si dhe pretendimit ankimor te OE ankues kundrejt OE te rekomanduar për kontrate, ESH sqaron si ne vijim: Hartimi i Dosjes së Tenderit është kërkesë e nenit 27 të LPP-së dhe nenit 17 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP). Në përputhje me nenin 17.12 të RRPP-së, "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në

fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë...." Vendosja e kërkesave, kritereve, kushteve specifikimeve apo dëshmive në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues. Dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit dytësor kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues qe kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ti specifikojnë në mënyrë të qartë jo diskriminuese dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik. Eksperti shqyrtues sqaron se, për çdo paqartësi lidhur me kriteret e përzgjedhjes të specifikuara nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, OE sipas nenit 53 të LPP-së mund të kërkoj sqarime shtesë nga AK brenda afatit ligjor të specifikuar në Dosjen e Tenderit, pra edhe në rastin konkret për çdo paqartësi lidhur me kriteret e përzgjedhjes të specifikuara nga AK , Operatoret Ekonomik kanë mundur t'i sqarojnë paraprakisht me Autoritetin Kontraktues, sepse Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë. Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, Eksperti shqyrtues sqaron se, Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se është i licencuar për tregti të karburanteve me pakicë dhe shumicë. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Licenca e importit –Valide 2.Licenca e shitjes me shumicë - Valide 3.Licenca e transportit - Valide 4.Licencën e shitjes më pakicë për pikat e karburantit ku Operatori Ekonomik ofron furnizime me karburante e te cilat i ka ne pronësi apo te marruara me qira – Valid Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sqaron se : AK në dosjen e tenderit ka kërkuar "Licencën e shitjes më pakicë për pikat e karburantit ku Operatori Ekonomik ofron furnizime me karburante e te cilat i ka ne pronësi apo te marruara me qira – Valide",pa e specifikuar distancen për pikat shpërnadarëse me pakicë për Mitrovicë dhe Prishtinë. Andaj, bazuar në kërkesën e lartë cekur në dosjen e tenderit, OE i rekomanduar për kontratë sipas kërkesës së AK-së i ka dorezuar Licencat për pikat të cilat operon OE i rekomanduar, rrjedhimisht e ploteson kërkesen e dosjes së tenderit. Ndërsa, sa i përket komunikimit të AK dhe OE të rekomanduar për kontratë lidhur me sqarimin e tenderit, konsideroj se, OE i rekomanduarka mundur të mos përgjigjet fare kërkesës së AK-së për informata shtesë, për faktin se, në oferten e tij ka ofruar Licencën e shitjes me pakicë për pikat e karburantit ku Operatori Ekonomik ofron furnizime me karburante e te cilat i ka ne pronësi apo te marruara me qira – Valide, rrjedhimisht kërkesa e në fjalë dosjes së tenderit është plotësuar. Megjithatë, edhe përkundër kësaj, AK me qëllim të implementimit të kontratës me kosto të shpenzimeve sa më të ulëta për AK, përmes Letrës Standarde ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë dhe sipas kërkesës për sqarime, OE i rekomanduar për kontratë ka deklaruar se, "kemi pike shitëse me pakice për rajonin e Mitrovicës, ne magjistralen Mitrovice Skenderaj ne vendin Ternac. Ndërsa për rajonin e Prishtinës ne magjistralen Prishtine-Ferizaj ne vendin Gadime e poshtme-Llugagji". Pra duke qenë se, AK në dosjen e tenderitnuk ka përcaktuar distancën për pikat shpërnadarëse me pakicë, Licenca e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit është i pabazuar. Ky konstatim mbeshtetet në faktin se: Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës të

paraqitura në këtë raport, si dhe duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit konsideroj se, AK ka bërë vlerësimin e tenderit në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së. Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP, përcakton : "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve". Autoriteti Kontraktues gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj: " Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë..." Po ashtu, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. "

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik ankues, janë vlerësuar si të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me disel dhe benzin" me nr. të prokurimit: "12997 12998-23-13076-1-1-1". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik "Petrol Company - SH.P.K dhe ka Vërtetuar Vendimin e AK -B58 të datës 21.12.2023, Autoritetit Kontraktues Trepça SH.A. lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Trepça SH.A.**
- OE - **Petrol Company - SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: